



VENDIM

Nr. 160, Datë 28.12.2015

**PËR
RINOVIMIN E LIÇENSËS SË SHOQËRISË GSA SH.P.K NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE,
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË
ERE-S NR. 57, DATË 22.06.2011**

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2 gërma “d” dhe 110 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4 pika 1 gërma “g”; 13 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i E.R.E, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2015, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k për rinovimin e liçensës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “GSA” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Të dhënat specifike sipas tipit të liçensës (neni 9, pika 4./10 gërmat “a”, “b” “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi :

1. Të rinovojë licensën e shoqërisë “GSA” sh.p.k në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr .57, datë 22.06.2011, për një afat 5 – vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI